



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 350, Datë 22.11.2023

MBI

**SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE NR. 133, DATË 06.06.2022 “MBI KËRKESËN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.166, DATË 10.10.2016, TË BORDIT TË ERE, E NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 451/a të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 03.09.2016 dhe Vendimit nr. 54 (86-2023-794), datë 18.10.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 22.11.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2130/1prot., datë 20.11.2023 të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve “Mbi shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE nr. 133, datë 06.06.2022 “Mbi kërkesën e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes, miratuar me vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, e ndryshuar”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016 ka miratuar “Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, të ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.177, datë 08.11.2016 “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve, të propozuara nga shoqëria OSSH sh.a, në Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes, të miratuar me vendimin nr. 166 të bordit të ERE, datë 10.10.2016”.
- Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), me shkresën nr. 5393 prot., datë 30.08.2021, bëri me dije se Këshilli i Ministrave kishte miratuar Vendimet nr. 245, datë 30.03.2016 “Për miratimin e rregullit teknik për kërkesat teknike në instalimin dhe kontrollin e dispozitivit diferencial, vendosur në pajisjet dhe instalimet elektrike dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, Vendimin nr. 482, datë 17.06.2020 “Për miratimin e rregullit teknik për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV”, si dhe Vendimin nr. 483, datë. 17.06.2020 “Për miratimin e rregullit teknik

*për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë mbi 1 kV”, të cilat sipas kërkesit kishin marrë fuqi ligjore të detyrueshme për zbatim nga ana e operatorëve dhe përdoruesve që veprojnë në treg.*

- Për sa më sipër, ISHTI paraqiti në ERE dy kërkesa për t’u reflektuar në “Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, të cilat konsistojnë: *së pari*, në përfshirjen në Rregullore të detyrimit të subjektit që kërkon të pajiset me lidhje të re për të bërë regjistrimin pranë ISHTI-t përpara vënies në shfrytëzim (dhënies së tensionit) vërtetuar me dokumentin përkatës të lëshuar prej tij dhe *së dyti*, në pikën 2.1, të kësaj Rregulloreje, për lidhje të reja në Tensionin e Ulët (TU), fuqia e instaluar 0 – 20 kW, të kërkohej nga ana e aplikantit, projekti elektrik përkatës.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 247, datë 13.12.2021, filloi procedurën mbi shqyrtimin e kërkesës së ISHTI-t dhe pas ndjekjes së të gjithë hapave proceduralë të parashikuar në ligj dhe në aktet nënligjore në fuqi, konkludoi me vendimin nr. 133, datë 06.06.2022.
- Shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., në cilësinë e palës së interesuar në procedurën sipërcituar, duke mos qenë dakord me vendimmarrjen e bordit të ERE, iu drejtua Gjykatës Administrative të Apelit duke kërkuar “*Shfuqizimin e aktit administrativ, vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 133, datë 06.06.2022 “Mbi kërkesën e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, i ndryshuar”.*
- Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 54 (86-2023-794), datë 18.10.2021 vendosi:
  1. *Pranimin e padisë.*
  2. *Shfuqizimin e vendimit nr. 133, datë 06.06.2022 të Bordit Rregullator të Energjisë Elektrike “Mbi kërkesën e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes, miratuar me vendimin nr. 166, date 10.10.2016, të Bordit të ERE, i ndryshuar (...)”.*
- Në nenin 451/a të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se: “*vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët*”, gjithashtu, Kodi i Procedurave Administrative në nenin 113, pika 1, parashikon se, *një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin.* Pika 2, vijuese e këtij neni, përcakton se, *shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm për të ardhmen dhe se shfuqizimi mund të jetë i pjesshëm apo i tërësishtëm*, ndërsa pika 3 përcakton formën ligjore të shfuqizimit të aktit, përkatësisht përmes një akti të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 133, datë 06.06.2022 “Mbi kërkesën e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren për

Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes, miratuar me vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, e ndryshuar”.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**